



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.69

2004

7 tetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9271 datë 9.9.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope" 4579
Ligj nr.9273 datë 16.9.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen "Për adoptimin e kushteve të njëjta për kontrollet teknike periodike të mjeteve me rrota dhe njohjen e ndërsjellë të kontrolleve të tilla"” 4580
Ligj nr.9274 datë 16.9.2004	Për një ndryshim në ligjin nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë" 4589
Ligj nr.9275 datë 16.9.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar..... 4589
Ligj nr.9276 datë 16.9.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar..... 4599
Vendim i Kuvendit nr.143, datë 9.9.2004	Për një shtesë në vendimin nr.134, datë 1.7.2004 "Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor", i ndryshuar..... 4601

Vendim i Kuvendit nr.144, datë 9.9.2004	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr.139, datë 22.7.2004 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për përgatitjen e projektligjit "Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë".....	4602
Vendim i Kuvendit nr.145, datë 23.9.2004	Për disa ndryshime në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.....	4603
Deklaratë e Kuvendit datë 6.9.2004		4604
Dekret nr.4332 datë 29.9.2004	Për lirim ambasadori.....	4605
Dekret nr.4339 datë 30.9.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4605
Dekret nr.4340 datë 30.9.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	4606

LIGJ
Nr.9271, datë 9.9.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7975, DATË 26.7.1995
"PËR BARNAT NARKOTIKE DHE LËNDËT PSIKOTROPE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Në Republikën e Shqipërisë ndalohen kultivimi i hashashit (*Papaver somniferum*) për prodhimin e opiumit dhe të kashtës, kultivimi i bimës së kokës (*Erythroxylon coca*) për prodhimin e alkaloidëve e të lëndëve aromatike, si dhe kultivimi i të gjitha llojeve dhe varieteteve të bimëve të gjinisë cannabis për prodhimin e kanabisit, të rrëshirës dhe vajit.

Lejohet kultivimi i kërpit (*Cannabis sativa L*) për qëllime industriale për prodhimin e fibrave dhe të farërave vetëm për varietetet që përmbajnë jo më shumë se 0,1 për qind tetrahidrokanabinol.

Importimi i farërave për varietetet, që përmbajnë nivelin e përcaktuar në këtë nen, bëhet me leje të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Masat e kontrollit dhe të monitorimit të subjekteve, që merren me këtë veprimtari, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrit të Rendit Publik.

Për qëllime të këtij ligji, termi "cannabis", i përmendur në paragrafin e parë, nënkupton majat e lulëzuara dhe të frutifikuara të bimëve të gjinisë cannabis, duke përjashtuar farërat dhe gjethet kur këto nuk janë të shoqëruara me majat, prej të cilave nuk është hequr rrëshira, pavarësisht nga emri që ato mund të kenë."

Neni 2

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

Prodhimi, fabrikimi, tregtimi ndërkombëtar, shitja me shumicë dhe pakicë, përdorimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përcaktuara në tabelën II, u lejohet vetëm personave të pajisur me licencë të posaçme për këto veprimtari.

Licenca nevojitet edhe për prodhimin, fabrikimin dhe tregtimin ndërkombëtar të bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përcaktuara në tabelën III.

Për objektet dhe ndërtesat ku do të kryhen veprimtaritë e mësipërme kërkohet leje e posaçme."

Neni 3

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Licenca për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në nenin 13, miratohet nga Komisioni Ndërmintor i përbërë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Komisioni Ndërmintor përcakton kriteret për pajisjen me licencë.”.

Neni 4

Neni 15 shfuqizohet.

Neni 5

Në tekstin e ligjit fjalët “Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit” bëhen “Ministria e Shëndetësisë”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4330, datë 23.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9273, datë 16.9.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN “PËR ADOPTIMIN E KUSHTEVE TË NJËJTA PËR KONTROLLET TEKNIKE PERIODIKE TË MJETEVE ME RROTA DHE NJOHJEN E NDËRSJELLË TË KONTROLLEVE TË TILLA””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen “Për adoptimin e kushteve të njëjta për kontrollet teknike periodike të mjeteve me rrota dhe njohjen e ndërsjellë të kontrolleve të tilla””, nënshkruar në Vjenë më 13 nëntor 1997.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4335, datë 29.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NË LIDHJE ME ADOPTIMIN E KUSHTEVE TË NJËJTA PËR KONTROLLET TEKNIKE PERIODIKE TË MJETEVE ME RROTA DHE TË NJOHJES RECIPROKE TË KONTROLLEVE TË TILLA

Palët Kontraktuese,

duke njohur shtimin e trafikut rrugor dhe si rezultat rritjen e rreziqeve dhe ndotjeve, të cilat janë të pranishme në Palët Kontraktuese me sigurinë dhe problemet e ambientit të një natyre të ngjashme dhe serioze;

duke dashur të arrijnë uniformitet sa më të lartë në rregullat që drejtojnë qarkullimin rrugor në Europë dhe si rrjedhojë një nivel më të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes së ambientit;

duke dashur të përcaktojnë për këtë qëllim kushte të njëjta mbi kontrollin teknik periodik të mjeteve me rrota që do të mjaftojë që këto mjete të plotësojnë në mënyrë që të certifikohen në vendin e tyre;

duke pasur parasysh që koha e nevojshme për kryerjen e kontrolleve të tilla teknike periodike të disa mjeteve me rrota dhe shpenzimi i shkaktuar në lidhje me këtë, janë faktorët të cilët mund të dëmtojnë kushtet e konkurrencës ndërmjet operatorëve të transportit rrugor në territoret e Palëve Kontraktuese; ndërkaq sistemet e sotme të testimit variojnë nga një territor në tjetrin;

duke pasur parasysh që kjo është e nevojshme për të harmonizuar sa më shumë të jetë e mundur frekuencën e testeve dhe artikujt e detyrueshëm për t'u testuar;

duke pasur parasysh fiksimin e datës së zbatimit të masave të referuara te kjo Marrëveshje, duhet të jepet kohë për masat administrative dhe teknike të kërkuara për kryerjen e provave të vendosura ose të zgjeruara për këtë qëllim,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të krijojnë rregulla për kontrollet teknike periodike të mjeteve me rrota të regjistruara ose të futura në shërbim në territorin e tyre dhe reciprokisht do të njohin kontrollet e kryera në përputhje me këto rregulla. Rregullat do të vendosen nëpërmjet një Komiteti Administrativ, i përbërë nga të gjitha Palët Kontraktuese në përputhje me rregullat e procedurës të treguara në shtojcën 1 dhe në bazë të paragrafëve dhe neneve të mëposhtme.

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

Termi "Mjete me rrota" do të përfshijë çdo automjet dhe rimorkiot e tyre;

Termi "Kontroll teknik" do të përfshijë kontrollin e çdo pajisjeje dhe pjesëve të cilat përdoren në mjetet me rrota dhe karakteristikat e të cilave kanë një lidhje me sigurinë rrugore, mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e energjisë;

Termi "Rregullat për kontrollet teknike periodike të mjeteve me rrota" do të përfshijë dispozitat për vërtetimin e procedurës së njëjtë administrative periodike sipas së cilës autoritetet kompetente të një Pale Kontraktuese deklarojnë, pas kryerjes së verifikimeve të kërkuara, që mjeti me rrota përmbush kërkesat e rregullave të dhëna.

Si provë do të shërbejë një certifikatë e kontrollit teknik, modeli i së cilës është riprodhuar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Një rregull, pasi është vendosur në përputhje me procedurën e treguar në shtojcën 1, do të komunikohet nga Komiteti Administrativ te Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, më poshtë i quajtur "Sekretariati i Përgjithshëm". Pas kësaj, Sekretariati i Përgjithshëm do t'ua japë njoftimin e këtij rregulli Palëve Kontraktuese, sa më shpejt të jetë e mundur.

Rregulli do të konsiderohet si i adoptuar, brenda një periudhe gjashtëmujore nga njoftimi i tij nga Sekretariati i Përgjithshëm. Përveç rastit kur më shumë se një të tretat e Palëve Kontraktuese në kohën e njoftimit informojnë Sekretariatit e Përgjithshëm mbi mospajtimin me rregullin.

Rregulli do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- a) Kategoritë e mjeteve me rrota, që kanë lidhje dhe frekuenca e kontrollit të tij;
- b) Pajisja dhe (ose) pjesët që inspektohen;
- c) Metodot e testit nëpërmjet të cilave do të demonstrohen çdo përmbushje e kërkesave;
- d) Kushtet për dhënien e certifikatës së kontrollit dhe njohja e tyre reciproke;
- e) Data (t) në të cilën rregulli hyn në fuqi.

Nëse nevojitet, rregulli mund të përfshijë referimet e qendrave të testimit të akredituara nga autoritetet kompetente ku kryhen kontrollet e mjeteve me rrota.

2. Kur një rregull është adoptuar, Sekretaria e Përgjithshme do të njoftojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha Palët Kontraktuese, duke specifikuar se cilat Palë Kontraktuese kanë kundërshtuar dhe në lidhje me të cilat rregulli nuk do të hyjë në fuqi.

3. Rregulli i adoptuar do të hyjë në fuqi brenda datës (datave) të specifikuara këtu si një rregull i aneksuar në këtë Marrëveshje për të gjitha Palët Kontraktuese, të cilat nuk kanë njoftuar mospajtimin e tyre.

4. Çdo Palë e re Kontraktuese mund të deklarojë, kur depoziton instrumentin e saj të pranimit, se nuk është e kufizuar nga rregulla të caktuara që i aneksohen kësaj Marrëveshjeje (ose nga ndonjëra prej tyre). Nëse, në këtë periudhë, procedura e vendosur në paragrafët 1,2 dhe 3 të këtij neni është duke kaluar si projektregull, Sekretariati i Përgjithshëm duhet t'ia komunikojë këtë projektregull Palës së re Kontraktuese dhe drafti duhet të hyjë në fuqi si rregull për Palën e re Kontraktuese vetëm në bazë të kushteve të specifikuara në paragrafin 3 të këtij neni, koha e lejuar fillon të llogaritet nga data e komunikimit të draftit te kjo Palë. Sekretariati i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për datën e hyrjes në fuqi të tij.

Gjithashtu, ai duhet t'u komunikojë atyre të gjitha deklaratat në lidhje me mosaplikimin e disa rregullave që ndonjë Palë Kontraktuese mund të bëjë në përputhje me termat e këtij paragrafi.

5. Çdo Palë Kontraktuese, duke aplikuar një rregull, në çdo kohë mund të njoftojë Sekretariatit e Përgjithshëm, subjekt i njoftimit njëvjeçar, që administrimi i saj ka për qëllim të ndalojë zbatimin e tij. Ky njoftim do të komunikohet nga Sekretariati i Përgjithshëm te Palët e tjera Kontraktuese.

6. Çdo Palë Kontraktuese, duke mos aplikuar një rregull, në çdo kohë mund të njoftojë Sekretariatit e Përgjithshëm, që ajo dëshiron pas kësaj e tutje ta zbatojë atë dhe rregulli do të hyjë në fuqi për këtë vend në ditën e 60-të pas këtij njoftimi.

Sekretariati i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për çdo hyrje në fuqi të një rregulli, për një Palë të re Kontraktuese të influencuar në përputhje me termat e këtij paragrafi.

7. Palët Kontraktuese për të cilat një rregull është në fuqi më tej do të referohen si "Palë Kontraktuese që aplikojnë një rregull".

8. Rregullat e aneksuara në këtë Marrëveshje si shtesë e kësaj Marrëveshjeje do të formojnë një pjesë të plotë të saj.

Neni 3

Rregullat e aneksuara kësaj Marrëveshjeje mund të amendohen në përputhje me procedurën e mëposhtme:

1. Amendamentet e rregullave do të vendosen nga Komiteti Administrativ, siç përshkruhet në nenin 1 dhe 2, dhe në përputhje me procedurën e treguar në shtojcën 1. Një amendament i

rregullit, pasi të jetë vendosur, do t'i komunikohet Sekretariatit të Përgjithshëm nga Komiteti Administrativ.

Pas kësaj, Sekretariati i Përgjithshëm do t'ua japë njoftimin e këtij ndryshimi Palëve Kontraktuese që aplikojnë rregullin, sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Një amendament i një rregulli do të konsiderohet i adoptuar vetëm kur, brenda një periudhe prej 6 muajsh nga njoftimi i tij nga Sekretariati i Përgjithshëm, më shumë se 1/3 e Palëve Kontraktuese, që aplikojnë rregullin në kohën e njoftimit, kanë informuar Sekretariatit e Përgjithshëm për mospajtimin e tyre me amendamentin.

Nëse, pas kësaj periudhe, Sekretariati i Përgjithshëm nuk ka marrë deklaratimet e mospajtimit të më shumë se 1/3 e Palëve Kontraktuese që aplikojnë rregullin, Sekretariati i Përgjithshëm, sa më shpejt të jetë e mundur, do të deklarojë amendimin si të adoptuar dhe detyrues për këto Palë Kontraktuese që aplikojnë rregullin, të cilët nuk e deklarojnë vetveten kundër tij.

Kur një rregull është amenduar dhe të paktën 1/5 e Palëve Kontraktuese aplikojnë rregullin e paamenduar, deklarojnë në vijim që ata dëshirojnë të vazhdojnë aplikimin e rregullit të paamenduar. Rregulli i paamenduar do të konsiderohet si një alternativë e rregullit të amenduar dhe do të përfshihet formalisht si i tillë brenda rregullit, me efekt nga data e adoptimit të amendimit ose hyrjes së tij në fuqi. Në këtë rast, detyrimet e Palëve Kontraktuese që aplikojnë rregullin do të jenë të njëjta si ato në paragrafin 1.

3. Nëse një Palë e re Kontraktuese do ta pranojë këtë Marrëveshje, ndërmjet kohës së njoftimit të amendimit të një rregulli nga Sekretariati i Përgjithshëm dhe hyrjes në fuqi të tij, rregulli në fjalë nuk do të hyjë në fuqi për këtë Palë Kontraktuese deri në 2 muaj pasi ajo e ka pranuar formalisht amendimin ose 2 muaj pas kalimit të një periudhe 6-mujore që nga komunikimi te kjo Palë i amendimit të propozuar nga Sekretariati i Përgjithshëm.

Neni 4

1. Vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, vendet e pranura nga Komisioni me cilësinë konsultative, në përputhje me paragrafin 8 të termave të referencës së Komisionit dhe organizatat e integritit ekonomik rajonal të ngritura nga vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, tek i cili vendet anëtare të tyre kanë transferuar fuqitë në fushat e mbuluara nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë fuqinë për të marrë vendime detyruese mbi vendet e tyre anëtare, mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje.

Për përcaktimin e numrit të votave referuar në nenin 2 paragrafi 1 dhe në nenin 3 paragrafi 2, organizatat e integritit ekonomik rajonal votojnë me numrin e votave të vendeve të tyre anëtare duke qenë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën.

2. Vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara si pjesëmarrëse të mundshme në aktivitetet përkatëse të Komisionit Ekonomik për Europën në lidhje me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit dhe të organizatave të integritit ekonomik rajonal të disa vendeve të cilat vendet anëtare të tyre kanë transferuar fuqitë në fushat e mbuluara nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë fuqinë për të marrë vendime detyruese mbi vendet e tyre anëtare që mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje.

Për përcaktimin e numrit të votave referuar nenit 2 paragrafi 1 dhe nenit 3 paragrafi 2, organizatat e integritit ekonomik rajonal votojnë me numrin e votave të vendeve të tyre anëtare duke qenë anëtare të Kombeve të Bashkuara.

3. Vendet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje:

- a) duke e nënshkruar atë pa rezervimin e një ratifikimi;
- b) duke e ratifikuar atë pas nënshkrimit të saj, subjektit ratifikimi;
- c) duke u pranuar në të.

4. Ratifikimi ose pranimi do të jetë i efektshëm pas depozitimit të një instrumenti në Sekretariatit e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Marrëveshja do të jetë e hapur për nënshkrim nga 13 nëntori 1997 deri më 30 qershor 1998 (duke e përfshirë). Pas kësaj, kjo do të jetë e hapur për pranim.

Neni 5

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 60-të, pasi 5 (pesë) nga vendet e referuara në paragrafin 1 të nenit 4 ta kenë firmosur atë pa rezervimin e ratifikimit ose të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të pranimit.

2. Për çdo vend ratifikimi ose pranimi në Marrëveshje bëhet sipas hyrjes së saj në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 60-të pasi vendi në fjalë ka depozituar instrumentet e tij të ratifikimit ose të pranimit.

Neni 6

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar kështu Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të bëhet efektiv 12 muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretariati i Përgjithshëm.

Neni 7

1. Çdo vend, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, pa rezervimin e ratifikimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose të pranimit, ose në çdo kohë pas kësaj, mund të deklarojë nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që Marrëveshja do të shtrihet te të gjitha ose në ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës.

Marrëveshja do të shtrihet në territorin ose territoret e caktuara në njoftim, nga dita e 60-të pas pranimit të tij nga Sekretariati i Përgjithshëm ose në qoftë se në këtë ditë Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi akoma, në kohën e hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo vend i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duke e shtrirë këtë Marrëveshje për çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ky është përgjegjës, mund ta denoncojë Marrëveshjen veçanërisht për këtë territor, në përputhje me dispozitat e nenit 6.

Neni 8

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, sa të jetë e mundur, duke negociuar ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje e cila nuk zgjidhet nga negocimi, duhet t'i paraqitet arbitrimin në qoftë se nga Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon kështu dhe do t'i referohet për zgjidhje një ose më shumë gjykatësve të zgjedhur nga Marrëveshja ndërmjet palëve në debat. Në qoftë se brenda 3 muajve nga data e kërkesës për gjykim, palët në debat janë të paafta të bien dakord në përzgjedhjen e një gjykatësi (arbitri) ose gjykatësve, çdonjëri nga këto vende mund t'i kërkojë Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojë një gjykatës, të cilit do t'i dërgohet mosmarrëveshja për vendim.

3. Vendimi i gjykatësit ose gjykatësve të emëruar në lidhje me paragrafin 2 të këtij neni do t'i detyrojë Palët Kontraktuese në debat.

Neni 9

1. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të deklarojë se ajo nuk e konsideron veten të kufizuar nga neni 8 i kësaj Marrëveshjeje. Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të kufizuara nga neni 8 në lidhje me ndonjë Palë Kontraktuese e cila ka paraqitur një rezervim të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese që ka paraqitur një rezervim të tillë siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, në çdo kohë mund ta tërheqë këtë rezervim duke njoftuar Sekretariatit e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Nuk do të lejohet asnjë rezervim tjetër i kësaj Marrëveshjeje ose i rregullave të aneksuara në të, por çdo Palë Kontraktuese, në përputhje me termat e nenit 2, mund të deklarojë që ajo nuk vendos të zbatojë rregulla të caktuara ose që ajo nuk vendos të zbatojë ndonjë prej tyre.

Neni 10

Teksti i vetë Marrëveshjes dhe i shtojcave të saj mund të amendohet në përputhje me procedurën e mëposhtme:

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente të kësaj Marrëveshjeje dhe shtojcave të saj. Teksti i çdo amendamenti të propozuar të Marrëveshjes dhe shtojcave të saj do t'i transmetohet Sekretariatit të Përgjithshëm, i cili do ta transmetojë atë te të gjitha Palët Kontraktuese dhe do të informojë të gjitha vendet e tjera referuar në paragrafin 1 të nenit 4.

2. Çdo amendim i propozuar që qarkullohet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të mendohet të pranohet nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk shpreh një kundërshtim brenda një periudhe prej 6-mujsh pas datës së qarkullimit të amendimit të propozuar nga Sekretariati i Përgjithshëm.

3. Sekretariati i Përgjithshëm do të njoftojë aq shpejt sa të jetë e mundur të gjitha Palët Kontraktuese, nëse është shprehur ndonjë kundërshtim i amendimit të propozuar. Nëse një kundërshtim i amendimit të propozuar është shprehur, amendimi do të paraqitet i papranueshëm dhe nuk do të ketë aspak asnjë efekt. Nëse nuk është paraqitur ndonjë kundërshtim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese 3 muaj pas skadimit të periudhës prej 6-mujsh referuar paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 11

Përveç njoftimit të parashikuar në nenin 2, 3 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje, Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë Palët Kontraktuese për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet, në përputhje me nenin 4;
- b) datat e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 5;
- c) denoncimet, në përputhje me nenin 6;
- d) njoftimet e marra, në përputhje me nenin 7;
- e) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 3;
- f) hyrja në fuqi e çdo ndryshimi, në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 3;
- g) hyrja në fuqi e çdo ndryshimi, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 5.

Neni 12

Personat fizikë ose institucionet e emëruara dhe të mbikëqyrura direkt nga Pala Kontraktuese mund të kryejnë kontrollet teknike periodike në përputhje me këtë Marrëveshje në favor të një Pale Kontraktuese.

Neni 13

Pas 30 qershorit 1998, origjinali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet në Sekretariatit e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të shpërndajë kopjet e certifikuara te të gjitha vendet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 4 të dhënë më lart.

Në dëshminë e të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Vjenë, më 13 nëntor 1997, në një kopje të vetme, në gjuhët anglisht, frëngjisht dhe rusisht, çdo tekst duke qenë autentikisht i barabartë.

SHTOJCË 1
PËRBËRJA DHE RREGULLAT E PROCEDURËS SË KOMITETIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Anëtarët e Komitetit Administrativ do të përbëhen nga të gjitha Palët Kontraktuese të Marrëveshjes.

Neni 2

Sekretaria Ekzekutive e Kombeve të Bashkuara të Komisionit Ekonomik për Europën do të aprovojë Komitetin me sekretariatin e shërbimeve.

Neni 3

Komiteti në sesionin e tij të parë të çdo viti, do të zgjedhë një kryetar dhe një zëvendës-kryetar.

Neni 4

Sekretariati i Pëgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të mbledhë Komitetin nën kujdesin e Komisionit Ekonomik për Europën, sa herë që një rregulli i ri ose një amendament i një rregulli është kërkuar të vendoset.

Neni 5

Rregullat e reja të propozuara do të vendosen gjatë votimit. Secili vend, Palë Kontraktuese në Marrëveshje, do të ketë një votë. Një numër i domosdoshëm anëtarësh jo më pak se gjysma e Palëve Kontraktuese, është kërkuar për qëllimin e marrjes së vendimeve. Për përcaktimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve, organizatat e integritit ekonomik rajonal duke qenë Palë Kontraktuese të Marrëveshjes votojnë me numrin e votave të vendeve të tyre anëtare. Përfaqësuesi i një organizate të integritit ekonomik rajonal mund të dorëzojë votat e vendeve përbërëse sovraane të saj të cilat aplikojnë rregullin. Projekti i rregullave të reja do të vendoset nga 2/3 e shumicës prezente në votim.

Neni 6

Ndryshimet e propozuara në rregull duhet të hidhen në votim. Secili vend, Palë Kontraktuese në Marrëveshje, që aplikon rregullat duhet të ketë një votë. Një prezencë jo më pak se gjysma e pjesëmarrësve të Palëve Kontraktuese që aplikojnë rregullin, kërkohet me qëllim marrjen e vendimit. Për vendosjen e prezencës, organizatat e integritit ekonomik rajonal, duke qenë Palë Kontraktuese në Marrëveshje, votojnë me numrin e votave të shteteve të tyre anëtare.

Përfaqësuesi i një organizate të integritit ekonomik rajonal mund t'ua shpërndajë votat e atyre vendeve përbërëse sovraane të cilat aplikojnë rregullin. Draftamendamentet e rregullave duhet të vendosen nga 2/3 e shumicës prezente në votim.

SHTOJCA 2

CERTIFIKATA NDËRKOMBËTARE E KONTROLLIT TEKNIK

1. Qendrat e kontrollit teknik të akredituara janë përgjegjëse për administrimin e provave të kontrollit, duke dhënë lejen e aprovimit me kërkesat e kontrollit (eve) përkatës të shtuar në Marrëveshjen e Vjenës së 1997 dhe specifikimi i datës më të vonshme (të fundit) të kontrollit tjetër të treguar në linjën Nr.12.5 të certifikatës ndërkombëtare të kontrollit teknik, modeli i së cilës është riprodhuar këtu më poshtë.

2. Certifikata ndërkombëtare e kontrollit teknik do të përmbajë informacionin e treguar më poshtë. Kjo do të jetë një broshurë në formatin A6 (148x105mm) me një kopertinë jeshile (të gjelbër) dhe të bardhë në faqet anësore ose një fletë jeshile, ose letër e bardhë në format A4(210x297) zmadhim i formatit A6, në mënyrë që pjesa përbërëse e shenjës dalluese të shtetit ose të Kombeve të Bashkuara formon kokën e certifikatës së zmadhuar.

3. Problemet e certifikatës dhe përmbajtja e tyre do të jenë shtypur në gjuhën kombëtare të botimit të Palëve Kontraktuese sipas renditjes numerike.

4. Raportet e kontrollit periodik të cilat janë në përdorim nga Palët Kontraktuese të Marrëveshjes, mund të jenë përdorur si një alternativë. Një mostër prej tyre do të transmetohet nga Sekretaria e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për informimin e Palëve Kontraktuese.

5. Dorëshkrimi, i shtypur ose i nxjerrë nga kompjuteri mbi certifikatën ndërkombëtare të kontrollit teknik, e bërë ekskluzivisht sipas autoriteteve kompetente, do të jetë i tipeve latine.

Shtojca 2

PËRMBAJTJA E CERTIFIKATËS NDËRKOMBËTARE TË KONTROLLIT TEKNIK

Hapësira për dallimin e stemës (shenjës) së shtetit ose të Kombeve të Bashkuara (Autoriteti administrativ përgjegjës për kontrollin teknik) 1/ CERTIFIKATA NDËRKOMBËTARE E KONTROLLIT TEKNIK.....2/
--

1/ Titulli “CERTIFIKATA NDËRKOMBËTARE E KONTROLLIT TEKNIK” në gjuhën kombëtare.

2/ Titulli në frëngjisht

CERTIFIKATË NDËRKOMBËTARE E KONTROLLIT TEKNIK

1. Targë makine (regjistrimi) No
2. Identifikimi i mjetit No
3. Regjistrimi i parë pas prodhimit (shteti, autoriteti).....1/
4. Data e regjistrimit të parë pas prodhimit.....
5. Data e kontrollit teknik.....

Certifikata e aprovuar

6. Kjo certifikatë është lëshuar për mjetet e identifikuar nën No.1 No.2, e cila i bindet datës nën No.5 me rregullin e shtuar Marrëveshjes së 1997 në adoptimin e kushteve të njëjta për kontrollet teknike periodike të mjeteve me rrota dhe njohjen reciproke të këtyre kontrolleve.
7. Mjeti ka pësuar kontrollin tjetër teknik të tij sipas rregullit(ave) nën No.6 jo më vonë se:

- Data: (muaji/viti).....
8. Lëshuar sipas.....
 9. Në (vendi).....
 10. Data.....
 11. Nënshkrimi.....
- 2/.

1/ Në qoftë se është e mundshme, shteti ose autoriteti ku mjeti është regjistruar për herë të parë pas prodhimit të tij.

2/ Vula ose stampa e autoritetit të lëshimit të certifikatës.

Shtojcë 2

12. Kontrolli teknik periodik pasues(it)1/

12. I.Dhënë sipas (qendrës së kontrollit teknik)2/.

2/12.2 (Vula)

Data

12.3

12.4 Nënshkrimi

- 12.5. Kontrolli tjetër i bërë jo më vonë se: (muaji/viti)

1/ Neni 12.1 deri 12.5 duhet përsëritur në qoftë se certifikata është përdorur vazhdimisht për periudhën njëvjeçare të inspektimit teknik.

2/ Emri, adresa, shteti i qendrës së inspektimit teknik, lëshuar nga autoriteti kompetent.

LIGJ
Nr.9274, datë 16.9.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8334, DATË 23.4.1998 “PËR PRIVATIZIMIN E
SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave mund të vendosë shitjen e paketës së aksioneve për ish-të përndjekurit politikë, brenda strukturës së formulës së privatizimit. Kjo paketë shitet me ankand, me bono dhe lekë privatizimi.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4336, datë 29.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9275, datë 16.9.2004

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995 “KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 dhe 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) krimet e korrupsionit aktiv dhe pasiv, të kryera nga persona që ushtrojnë funksione në sektorin publik ose atë privat”.

Neni 2

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Forma të veçanta të bashkëpunimit

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Organizata kriminale, për realizimin e qëllimeve të saj, përdor forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimin dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarive ekonomike, të koncesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike, për të realizuar përfitime ose avantazhe të padrejta për vete a personat e tjerë ose për të ndaluar a penguar ushtrimin e lirë të së drejtës së votës gjatë fushatave zgjedhore, si dhe veprimtarive të tjera të ngjashme me to.

2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, që synon kryerjen e veprimeve të dhunshme për qëllime terroriste, si përmbysje të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe të pasigurisë në masë.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kërret V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar.

5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.

6. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.”.

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 30, fjalët “detyra si nëpunës shtetëror ose në shërbim publik” zëvendësohen me fjalët “funksione publike”.

Neni 4

Në paragrafin e katërt të nenit 34, fjalët “5 milionë” zëvendësohen me “3 milionë”.

Neni 5

Neni 35 riformulohet si më poshtë:

“Neni 35

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një kohë jo më pak se pesë vjet, jepet detyrimisht ndaj personit që ka kryer një krim, që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim, për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike mund të jepet për një kohë nga tre deri në pesë vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga një deri në tre vjet, kur është caktuar dënimi deri në tre vjet burgim.”.

Neni 6

Në fund të nenit 40 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur dënimi i dhënë nga gjykata është jo më pak se pesë vjet burgim, kjo e drejtë mund të hiqet për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet”.

Neni 7

Pas nenit 44 shtohet neni 45 me këtë përmbajtje:

“Neni 45

Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë

Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.

Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale.

Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë.”.

Neni 8

Shkronja “dh” e nenit 50 ndryshohet si më poshtë:

“dh) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar.”.

Neni 9

Në shkronjën “c” të nenit 79, fjala “nëpunësit” zëvendësohet me fjalët “funksionarët e tjerë”.

Neni 10

Në nenin 109 bëhen këto shtesa:

- në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët “dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë”;

- në fund të paragrafit të dytë shtohen fjalët “dhe me gjobë nga tre milionë deri në shtatë milionë lekë”;
- në fund të paragrafit të tretë shtohen fjalët “si dhe me gjobë nga pesë milionë deri në dhjetë milionë lekë”.

Neni 11

Pas nenit 109/a shtohet neni 109/b me këtë përmbajtje:

“Neni 109/b

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, për të fituar padrejtësisht pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për vete ose për të tretë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në tre milionë lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet duke përdorur a kërcënuar me përdorimin e armës, torturës, akteve çnjerëzore e poshtëruese që kanë shkaktuar dëmtime të shëndetit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga pesë milionë deri në dhjetë milionë lekë.”.

Neni 12

Neni 134 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 134

Vjedhja

Vjedhja e pasurisë dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

Neni 13

Pas nenit 164 shtohen nenet 164/a dhe 164/b me këtë përmbajtje:

“Neni 164/a

Korrupsioni aktiv në sektorin privat

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë deri në një milion lekë.

Neni 164/b

Korrupsioni pasiv në sektorin privat

Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij,

dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në tre milionë lekë.”.

Neni 14

Pas nenit 170/a shtohet neni 170/b me këtë përmbajtje:

“Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës

Kryerja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, e veprimeve të konkurrencës me anë të dhunës dhe kërcënimit dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kur veprimet e konkurrencës drejtohen ndaj veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdo mënyre nga shteti ose entet publike, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.”.

Neni 15

Në paragrafin e parë të nenit 190, fjalët “katër mijë” zëvendësohen me fjalët “katërqind mijë”.

Neni 16

Pas nenit 230/a shtohen nenet 230/b, 230/c dhe 230/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin

Transferimi, konvertimi, fshehja, lëvizja ose tjetërsimi i fondeve dhe i pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, për të shmangur zbulimin dhe vendndodhjen e tyre, dënohen me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në gjashtë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në tetë milionë lekë, ndërsa kur kryerja e kësaj vepre ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë milionë deri në dhjetë milionë lekë.

Neni 230/c

Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit

Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Neni 230/ç

Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur

Dhënia e fondeve dhe pasurive të tjera, kryerja e shërbimeve financiare, si dhe e transaksioneve të tjera me persona të shpallur, ndaj të cilëve zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në pesë milionë lekë.”.

Neni 17

Pas nenit 234 shtohen nenet 234/a dhe 234/b me këtë përmbajtje:

“Neni 234/a

Organizata terroriste

Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës terroriste dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 234/b

Banda e armatosur

Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i bandës së armatosur dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në bandën e armatosur dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Neni 18

Neni 244 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 244

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.”.

Neni 19

Neni 245 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 245

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.”.

Neni 20

Pas nenit 245 shtohen nenet 245/1 dhe 245/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 245/1

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, përbëjnë vepër penale dhe dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.

Neni 245/2

Përfshirimi nga vuajtja e dënimit

Personi, që ka premtuar ose ka dhënë shpërblim ose përfitime të tjera, sipas neneve 164/1, 244, 245, 312, 319 dhe 328 të këtij Kodi, mund të përfitojë përfshirje nga dënimi ose ulje të tij, sipas rregullave të parashikuara në nenin 28 të këtij Kodi, nëse bën kallëzim dhe jep ndihmesë në procedimin penal të këtyre veprave.

Në dhënien e vendimit, gjykata mban parasysh edhe kohën kur është bërë kallëzimi, ardhjen ose jo të pasojave të veprës.”.

Neni 21

Neni 248 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 248

Shpërdorimi i detyrës

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.”.

Neni 22

Neni 259 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë .”.

Neni 23

Neni 260 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 260

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë .”.

Neni 24

Në paragrafin e parë të nenit 287, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) përdorimit dhe investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve, që janë produkte të veprave penale.”.

Neni 25

Pas paragrafit të parë të nenit 302 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër kur kryhet në lidhje me veprat penale, të parashikuara në nenet 234/a, 234/b, 284/a, 333 e 333/a të këtij Kodi, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet”.

Neni 26

Pas paragrafit të dytë të nenit 306 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër kur kryhet në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet 234/a, 234/b, 284/a 333 e 333/a të këtij Kodi, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.”.

Neni 27

Neni 312 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 312

Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tretë, dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit, për të siguruar deklarime ose dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrimeve të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohen me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.”.

Neni 28

Pas nenit 312 shtohet neni 312/a me këtë përmbajtje:

“Neni 312/a

Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë

Kanosja ose vepra të tjera dhune, që i bëhen personit për të siguruar deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrave të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 29

Pas nenit 313/a shtohet neni 313/b me këtë përmbajtje:

“Neni 313/b

Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin

1. Bërja publike, edhe në organe të medias, në kundërshtim me ligjin e të dhënave me karakter të klasifikuar dhe konfidencial, që rrezikojnë jetën, integritetin fizik ose lirinë e personave të mbrojtur, sipas ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet dhe, kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre, me burgim nga 6 muaj deri në tre vjet.

2. Kur kjo veprë kryhet nga njëri prej personave që kanë përgjegjësinë për të ruajtur karakterin e klasifikuar dhe konfidencial të të dhënave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe, kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre, me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”.

Neni 30

Neni 319 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 319

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit deri në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në dy milionë lekë.”.

Neni 31

Pas nenit 319 shtohet neni 319/a me këtë përmbajtje:

“Neni 319/a

Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë deri në katër milionë lekë.”.

Neni 32

Neni 333 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 333 **Organizata kriminale**

Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në një organizatë kriminale dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Nëse organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyes për qëllime të përmbushjes së veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato janë të fshehura ose të mbajtura në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.

Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës kriminale, financohen tërësisht ose pjesërisht me produkte të veprave penale, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij.”.

Neni 33

Pas nenit 333 shtohet neni 333/a me këtë përmbajtje:

“Neni 333/a **Grupi i strukturuar kriminal**

Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”.

Neni 34

Në nenin 334 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.”.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4337, datë 29.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9276, datë 16.9.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 “KODI I
PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pikat 2 dhe 3 të nenit 13 ndryshohen si më poshtë:

“2. Në gjykatat e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar:

- a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;
- b) kërkesat për ekzekutimin e vendimeve;
- c) kërkesat për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ato ushtarake gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me përjashtim të kërkesave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, që shqyrtohen nga një gjyqtar.”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

“3. Gjykata e apelit për krimet e rënda shqyrton në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata për krimet e rënda. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.”.

Neni 3

Pas nenit 37 shtohet neni 37/a me këtë përmbajtje:

“Neni 37/a

Bashkëpunimi me drejtësinë

1. Personi nën hetim ose i pandehuri, që akuzohet për një krim të rëndë, të kryer në bashkëpunim, kur bashkëpunon me prokurorin dhe gjykatën, duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat, që shërbejnë si prova vendimtare për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara prej tyre.

Për dënimin e tij zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 28 të Kodit Penal.

2. Kushtet e bashkëpunimit caktohen në marrëveshjen e mbrojtjes, të hartuar sipas dispozitave të posaçme ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

3. Kur marrëveshja e bashkëpunimit realizohet gjatë gjykimit, gjykata që shqyrton çështjen vendos uljen e masës së dënimit ose përjashtimin nga dënimi, sipas nenit 28 të Kodit Penal. Kur bashkëpunimi realizohet gjatë ekzekutimit të vendimit të dënimit, bashkëpunëtori i drejtësisë mund të kërkojë nga gjykata që e ka dënuar ose nga ajo e vendit të ekzekutimit ndryshimin e dënimit të dhënë. Gjkata vendos pasi merr edhe mendimin e prokurorit.

4. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të revokohet kur bashkëpunëtori i drejtësisë shkel kushtet e përcaktuara ose bën deklaramë të rreme.”.

Neni 4

Neni 75/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 75/a

Kompetencat e gjykatës për krime të rënda

Gjkata e krimeve të rënda gjykon krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 79 shkronjat “c” dhe “ç”, 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 233, 234, 234/a, 234/b, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte, që janë në kompetencë të gjykatave ushtarake ose nga të miturit.”.

Neni 5

Pas nenit 167 shtohet neni 167/a me këtë përmbajtje:

“Neni 167/a

Pyetja në distancë e një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur ose që vuan dënimin jashtë shtetit

I pandehuri në një procedim të lidhur, i proceduar ose që vuan dënimin jashtë shtetit për një vepër tjetër penale, kur refuzohet ekstradimi i tij, mund të pyetet në distancë, me anë të lidhjes audiovizive, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, me kusht që shteti i huaj të garantojë pjesëmarrjen e mbrojtësit të të pandehurit në vendin ku kryhet marrja në pyetje.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 294 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pas ndërhyrjes së prokurorit, Policia Gjyqësore kryen të gjitha veprimet e domosdoshme hetimore, si dhe çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar nga prokurori.” .

Neni 7

Pas pikës 6 të nenit 361 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.”.

Neni 8

Pas nenit 361 shtohet neni 361/a me këtë përmbajtje:

“Neni 361/a

Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur

1. Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve.

Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361.

2. Kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët.

Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm për përmbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.”.

Neni 9

Pas pikës 2 të nenit 363 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Eksperti mund të pyetet në distancë, duke respektuar rregullat e parashikuara në pikën 7 të nenit 361 të këtij Kodi.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4338, datë 29.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM

Nr.143, datë 9.9.2004

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.134, DATË 1.7.2004 "PËR KRIJIMIN E
KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË PËRBASHKËTA TË OSBE/ODIHR-IT DHE KOMISIONIT TË
VENECIAS PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.134, datë 1.7.2004 "Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor", i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

- I. Në pikën II shtohet në përbërje të Komisionit Parlamentar deputeti Aleksandër Garuli.
II. Në fund të pikës III shtohet fjalia si më poshtë:
"Në afatin e veprimtarisë së Komisionit nuk llogaritet muaji gusht".
III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.144, datë 9.9.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.139, DATË 22.7.2004 "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR PËRGATITJEN E PROJEKTLIGJIT "PËR NDARJEN E RE ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.139, datë 22.7.2004 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për përgatitjen e projektligjit "Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë" bëhet shtesa si më poshtë:

- I. Në pikën II shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në përbërje të Komisionit të Posaçëm të Kuvendit caktohen:

- | | |
|---------------------|-------------------|
| 1. Ylli Bufi | PSSH |
| 2. Niko Faber | PSSH |
| 3. Taulant Dedja | PSSH |
| 4. Stefan Çipa | PSSH |
| 5. Lekë Çukaj | PSDSH |
| 6. Neritan Ceka | QLD |
| 7. Ndue Preka | PAASH |
| 8. Ndre Legisi | LSI |
| 9. Fatos Beja | PD |
| 10. Luan Skuqi | PD |
| 11. Luigj Gjoka | PD |
| 12. Sali Shehu | PD |
| 13. Neritan Alibali | PR |
| 14. Ilir Berzani | PDr |
| 15. Shpëtim Roqi | LZHK |
| 16. Alfred Çako | Grupi i Djathtë". |

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.145, datë 23.9.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 24, 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, bazuar në listën e kandidatëve të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në Komisionin për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore:

1. Elmaz Sherifi	PS	Kryetar
2. Sotir Kokeri	PS	Sekretar
3. Banush Gozhdari	PS	Anëtar
4. Rahmi Mehmetllari	PS	Anëtar
5. Spartak Braho	LSI	Anëtar
6. Mustafa Muçi	LSI	Anëtar
7. Vladimir Malo	PA	Anëtar

- Në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet:

1. Mustafa Muçi	LSI	Anëtar
-----------------	-----	--------

- Në Komisionin për Politikën e Jashtme:

1. Ilir Meta	LSI	Anëtar
2. Skënder Gjinushi	PSD	Anëtar

- Në Komisionin për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin:

1. Dritan Prifti	LSI	Anëtar
------------------	-----	--------

- Në Komisionin e Mbrojtjes:

1. Ardian Myslymaj	PS	Zëvendëskryetar
2. Asllan Haxhiu	PS	Anëtar
3. Sabit Brokaj	LSI	Anëtar

- Në Komisionin e Rendit dhe SHISH-it:

1. Stefan Çipa	PS	Zëvendëskryetar
2. Ardit Kaja	PS	Anëtar
3. Ndre Legisi	LSI	Anëtar

- Në Komisionin e Punës dhe Çështjeve Sociale:

1. Valentina Leskaj	PS	Kryetare
2. Monika Kryemadhi	LSI	Anëtare

- Në Komisionin për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë:

- | | | |
|------------------|-----|----------|
| 1. Flamur Hoxha | PS | Kryetar |
| 2. Durim Hushi | PS | Sekretar |
| 3. Ndriçim Hysa | PS | Anëtar |
| 4. Eduart Alushi | LSI | Anëtar |

- Në Komisionin për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet:

- | | | |
|------------------|-----|-----------------|
| 1. Agron Tato | PS | Zëvendëskryetar |
| 2. Limoz Dizdari | LSI | Anëtar |

- Në Komisionin për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen e Mjedisit:

- | | | |
|-----------------|-----|--------|
| 1. Sabit Brokaj | LSI | Anëtar |
|-----------------|-----|--------|

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

DEKLARATË

Tiranë, më 6 shtator 2004

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me aktet e dhunës të ushtruara ndaj emigrantëve shqiptarë në Athinë e në qytete të tjera greke dhe sidomos me vrasjen e shtetasit shqiptar Gramoz Palushi,

Shpreh keqardhjen e tij të thellë për këto shfaqje, që janë në kundërshtim me frymën e miqësisë e të bashkëpunimit që duhet të karakterizojë marrëdhëniet midis dy popujve e dy vendeve tona. Ashtu si festuan grekët në Portugali dhe në çdo cep të globit, pa asnjë pasojë mbi ta, në rastin e fitores së Kampionatit European, është legjitime që shqiptarët kudo që janë t'i gëzohen fitores së tyre dhe në çdo rast atyre duhet t'u njihet e drejta për t'u mbledhur, për të festuar ose protestuar, duke respektuar ligjet e vendit ku ata punojnë dhe jetojnë ndershmërisht.

Veprimtaritë sportive janë ura të ndërtimit të miqësisë dhe jo të akteve të ksenofobisë, urrejtjes ose racizmit, ashtu siç qenë edhe Lojërat Olimpike të zhvilluara në muajin gusht në Athinë, për mbarëvajtjen e të cilave Shqipëria dhe emigrantët shqiptarë në Greqi dhanë kontributin e tyre;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u kërkon strukturave të shtetit grek që të ndërmarrin akte konkrete ndaj gjithë atyre që ushtruan dhunë mbi shqiptarët, në mënyrë të veçantë nxjerrjen para drejtësisë të vrasësit të emigrantit shqiptar Gramoz Palushi.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka bindjen se marrëdhëniet e mira me Greqinë janë të rëndësishme dhe me interes për të dyja vendet, por ato asnjëherë nuk do të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata pa respektimin reciprok të të drejtave dhe dinjitetit të shtetasve të të dyja vendeve.

DEKRET
Nr.4332, datë 29.9.2004

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Pëllumb Xhufi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4339, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ramadan Myftar Idrizaj
2. Atije Fazlija Idrizaj (Maraj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4340, datë 30.9.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|--|
| 1. Agron Kost Sulanjaku | 9. Dorian Sebastian Krenar Arifi |
| 2. Liri Llazar Sulanjaku (Piku) | 10. Fatbardha Muhamet Adrio (Bardulla) |
| 3. Valbona Kolë Kolnikaj | 11. Aleksandër Ujk Sterkaj |
| 4. Spiro Mazllëm Lumani | 12. Manuel Thomas Aleksandër Sterkaj |
| 5. Afrim Mehmet Sinani | 13. Eugen Reimond Aleksandër Sterkaj |
| 6. Belinda Afrim Sinani | 14. Rita Lazër Sterkaj (Veshti) |
| 7. Klea Afrim Sinani | 15. Alerta Aleksandër Sterkaj |
| 8. Krenar Halil Arifi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 7.10.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë